



PLANI VENDOR I VEPRIMIT

PËR BARAZINË GJINORE

2026 – 2031

Përgatitur nga Bashkia Mallakastër
në kuadër të zbatimit të
Kartës Evropiane për Barazi
të grave dhe burrave në jetën vendore

Maj 2026

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026 – 2031 u përgatit nga Bashkia Mallakastër me mbështetjen e Eksperteve të Barazisë Gjinore në kuadër të zbatimit të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian

Grupi I Punes

Znj. Naime Dervishaj
Znj. Aurora Heqimaj
Znj. Kleidja Hoxhaj
Znj. Jonida Llaka
Znj. Aurora Veizaj

Drejtoreshë e Kultures
Specialist /Sektori Juridik
Pergjessgjese Sektori Çështjeve Sociale
P/Sektori Burimeve Njerezore
Specialist Sektori i Çështjeve Sociale

Ekspertiza teknike

.....
.....

Fjala e Kryetarit të Bashkisë

Bashkia Mallakastër ka vite që e ka prioritet barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave. Ky angazhim buron nga bindja se një shoqëri e barabartë është një shoqëri më e fortë dhe më e zhvilluar.

Për të adresuar nevojat specifike të grave, të rejave, vajzave, si dhe burrave, të rinjve e djemve, në janar 2025, Bashkia Mallakaster nënshkroi Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Ky dokument, i përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane, shënon një hap të rëndësishëm drejt veprimeve të unifikuara dhe të suksesshme.

Menjëherë pas kësaj, i gjithë stafi i bashkisë u angazhua në hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2031. Ky plan, një mjet thelbësor për zbatimin praktik të parimeve të barazisë gjinore, u zhvillua përmes një procesi gjithëpërfshirës. Ne komunikua drejtpërdrejt me gratë, burrat, të rejtat e të rinjtë në të gjitha lagjet dhe zonat rurale të bashkisë sonë, duke u siguruar që zëri i të gjithave/gjithëve të dëgjohej.

Nga nevojat, sugjerimet dhe pritshmëritë e drejtpërdrejta të grupeve me të cilat konsultuam, hartuam objektiva të qarta dhe të matshme për ndërhyrje. Në qendër të të gjitha veprimeve tona do të jenë gratë, të rejtat dhe vajzat, veçanërisht nga grupet më pak të përfaqësuara. Synimi ynë është t'u japim të gjithave / gjithëve mundësi të barabarta, me qëllim që të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre, të fuqizohen dhe të përparojnë në çdo fushë të jetës shoqërore.

Barazia mes grave dhe burrave nuk është privilegj, por një e drejtë themelore. Gratë, të rejtat dhe vajzat kanë të drejtë të jetojnë me dinjitet, të respektohen në shoqëri, t'u jepen mundësi të barabarta dhe të gëzojnë të drejtat e tyre, të çliroara nga frika dhe dhuna. Për më tepër, barazia gjinore është një parakusht për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Gratë e fuqizuara kontribuojnë drejtpërdrejt në shëndetin dhe produktivitetin e familjeve dhe komuniteteve të tyre, duke përmirësuar ndjeshëm perspektivat për brezat e rinj.

Tabela e Permbajtjes

Contents.....	4
Article I. Lista e Shkurtimeve.....	5
Article I. I.Hyrje.....	8
Article II. II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL.....	10
Article III. III. METODOLOGJIA.....	13
Article IV. IV.VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË	19
Article V. V.REZULTATET E PRITSHME, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE TREGUESIT	20
Article VI. VI.KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2026 – 2031	22
Article VII. VII. RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	25
VIII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026-2031	26

Lista e Shkurtimeve

AGK	Aleanca e Grave Këshilltare
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAË	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DAB	Drejtoria e Auditit të Brendshëm
DANJAAMTP	Drejtoria e Administrimit të NJA dhe AMTP
DB	Drejtoria e Buxhetit
DEC	Drejtoria e Emergjencave Civile
DF	Drejtoria e Financës
DDH	Drejtoria e të Dhënave
DI	Drejtoria e Inovacionit

DIEPH	Drejtoria e Integrimit Evropian dhe Projekteve të Huaja
DIPN	Drejtoria e Inovacionit dhe Projekteve Natyrore
DJ	Drejtoria Juridike
DKD	Drejtoria e Koordinimit me Donatorët
DKQ	Drejtoria e Komunikimit me Qytetarët
DKSSHI	Drejtoria e Kujdesit Social dhe Shërbimet e Integruara
DKTK	Drejtoria e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore
DLGJC	Drejtoria e Licensimit dhe Gjendjes Civile
DMK	Drejtoria e Medias dhe Komunikimit
DMPS	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale
DMTTV	Drejtoria e Monitorimit të Taksës dhe Tarifave Vendore
DNKRRN	Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike dhe Rreziqeve Natyrore
DNP	Drejtoria e Nxitjes së Punësimit
DPEM	Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor
DPLA	Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore
DPZHIT	Drejtoria e Promovimit dhe Zhvillimit të Industrisë së Turizmit
DR	Drejtoria e Rinisë
DREC	Drejtoria e Rindërtimit të Emergjencave Civile
DRSHS	Drejtoria e Rindërtimit të Shërbimeve Sociale
DS	Drejtoria e Sportit
DSS	Drejtoria e Strehimit Social
DTIK	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
DTTRR	Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor
DTZH	Drejtoria e Trajnimit dhe Zhvillimit
DVPMAMS	Drejtoria e Vlerësimit të Performancës, Masave Administrative dhe Motivimit të Stafit
DZHER	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural
DZHEU	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (për rastet e dhunës në familje)
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)

KB	Këshilli Bashkiak
KBGJ	Komisioni për Barazinë Gjinore
KBRE	Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës
KV	Koordinatorë/Koordinator Vendor kundër dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJA	Njësi administrative
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OS	Objektivi Specifik
PVVBJ	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2031)
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

I.Hyrje

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026–2031 është dokumenti strategjik dhe operacional i Bashkisë Mallakastër për zbatimin e angazhimeve të saj në fushën e barazisë gjinore. Ky plan hartohet në funksion të zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të nënshkruar nga Bashkia Mallakastër dhe të promovuar nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (CEMR).

Përmes nënshkrimit të kësaj Karte, Bashkia Mallakastër ka marrë një angazhim publik për të promovuar dhe garantuar barazinë gjinore në të gjitha fushat e jetës vendore, duke ndërmarrë masa konkrete për reduktimin e pabarazive dhe për forcimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në proceset vendimmarrëse dhe në zhvillimin lokal. PVVBGJ përbën instrumentin kryesor për kthimin e këtij angazhimi në veprime të matshme, të koordinuara dhe të qëndrueshme.

Hartimi i këtij plani është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe ndërveprues, i realizuar në bashkëpunim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, median, sektorin privat, Këshillin Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak. Prosesi është mbështetur nga Bashkia Mallakastër dhe Grupi i Ekspertëve për Barazinë Gjinore, në kuadër të projektit “Zbatimi i Kuadrit Ligjor (Acquis) të Bashkimit Evropian për Barazinë Gjinore” (EU4GE).

PVVBGJ bazohet në parimet themelore të barazisë dhe drejtësisë gjinore. Barazia gjinore nënkupton që të gjitha gratë dhe burrat kanë të drejtën të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë dhe të bëjnë zgjedhje të lira nga kufizimet e stereotipeve dhe roleve të ngurta gjinore. Ajo nuk nënkupton uniformitet, por garantimin e të drejtave, përgjegjësisë dhe mundësisë të barabarta për të gjithë individët, pavarësisht gjinisë së tyre. Në këtë kuptim, PVVBGJ synon të forcojë qasjen e Bashkisë Mallakastër drejt një qeverisjeje vendore gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, duke integruar parimet e barazisë në politikën, shërbimet dhe zhvillimin lokal.

Dokumenti shërben si një udhërrëfyes për veprim të koordinuar institucional dhe ndërsektorial, me qëllim ndërtimin e një komuniteti më të drejtë, më të barabartë dhe më të qëndrueshëm.

Në përputhje me Kartën Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si niveli më i afërt me qytetarët, kanë një rol kyç në identifikimin dhe adresimin e pabarazive gjinore. Përmes bashkëpunimit me të gjithë aktorët vendorë, Bashkia Mallakastër angazhohet të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie ku barazia gjinore është realitet i prekshëm dhe i qëndrueshëm.

Zbatimi dhe promovimi i së drejtës për barazi ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, si dhe të të gjitha grupeve shoqërore, përbën një parim themelor të qeverisjes vendore dhe një element thelbësor të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kuadër, Bashkia Mallakastër luan një rol të rëndësishëm në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për avancimin e barazisë gjinore dhe reduktimin e pabarazive ekzistuese në nivel lokal.

Bashkia Mallakastër, përmes angazhimeve të saj institucionale dhe bashkëpunimit me aktorë lokalë, ka punuar në drejtim të përmirësimit të shërbimeve sociale, fuqizimit të grave dhe vajzave, rritjes së aksesit në shërbime komunitare dhe mbështetjes së grupeve më të cenueshme të shoqërisë. Këto përpjekje synojnë të forcojnë përfshirjen sociale dhe të krijojnë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjinisë, moshës apo statusit social.

Megjithatë, pavarësisht progresit të arritur dhe përafrimit të kuadrit vendor me politikën kombëtare dhe standardet ndërkombëtare, pabarazitë gjinore dhe format e ndryshme të diskriminimit vazhdojnë të jenë të pranishme në shoqëri. Këto pabarazi shpesh burojnë nga stereotipe të rrënjosura në strukturat familjare, arsimore, ekonomike dhe kulturore, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në mundësitë dhe zhvillimin e individëve në komunitet.

Për këtë arsye, integrimi i perspektivës gjinore në politikën, programet dhe praktikën e Bashkisë Mallakastër është një domosdoshmëri për arritjen e barazisë reale. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve përbën një faktor kyç për forcimin e kohezionit social dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të territorit.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë Mallakastër është i harmonizuar me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, me kuadrin ligjor kombëtar dhe me politikën dhe strategjitë përkatëse të zhvillimit. Ai mbështetet gjithashtu në përvojat e mëparshme institucionale dhe në sfidat e identifikuara gjatë zbatimit të planeve të mëparshme të veprimit, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të qasjes gjinore në nivel vendor.

Një fokus i rëndësishëm i këtij plani është kalimi nga trajtimi i pjesshëm i çështjeve gjinore në integrimin e plotë të perspektivës gjinore në planifikim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të politikave vendore. Kjo përfshin përdorimin e treguesve të ndjeshëm gjinorë dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës dhe faktorëve të tjerë socialë, me qëllim rritjen e cilësisë së analizës dhe vendimmarrjes.

Plani gjithashtu i kushton vëmendje të veçantë grupeve të cenueshme, përfshirë gratë dhe vajzat nga zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet në vështirësi socio-ekonomike, si dhe individët që përballen me forma të ndryshme diskriminimi.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë Plan Vendor Veprimi janë të strukturuar me objektiva të qarta, tregues të matshëm, institucione përgjegjëse, afate kohore dhe burime të përcaktuara, duke synuar rritjen e transparencës, efektivitetit dhe ndikimit të politikave të barazisë gjinore në Bashkinë Mallakastër.

II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Nën nenin 18 të kushtetutës qartësohet shprehimisht se: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligjje e arsyeshme dhe objektive.” Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentash ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zenë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem i parashikimeve në instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe avancimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

Instrumente ndërkombëtarë

Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality)

Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË)

Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA)

Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)

Objektivat e Zhvillimit të Qendrushëm (OZHQ)

Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- Ligjin 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar
- Ligji nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”

- Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar
- Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”
- Ligji 22/2018 “Për strehimin social”
- Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”
- Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, etj.

Politikat kombëtare

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2022 – 2024 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2031.

Institucionet përgjegjëse

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe aktorët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse bashkia nuk ka mandat të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mandat. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, nën koordinimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe Aleanca e Grave Këshilltare dhe Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Sipërmarrjen e Grave në nivel të Këshillit Bashkiak. Po kështu me rëndësi është edhe formalizimi i një Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie i përbërë nga përfaqësuese dhe përfaqësues të Drejtorive kryesore përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan.

¹ Miratuar me VKM 400, datë 31.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2031.docx>

Ky Komision, do të mundësonte një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe për ata elementë që nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që siç u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për avancimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave dhe arritjen e barazisë gjinore (psh ky Komision do të mundësonte përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha dokumentat zhvillimore të bashkisë, pavarësisht sektorit apo çështjes që mbulojnë). Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe OJF të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në avancimin drejt barazisë gjinore.

Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PVVBGJ.

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2026 - 2031 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

Ngritja e Grupit të Punës. Grupi i Punës për hartimin e këtij PVVBGJ u ngrit me Urdhër të Kryetarit, nr. 195, datë 15.05.2026 "Për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2031". Në përbërje të këtij grupi ishin 5 anëtare gra.

Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review). Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.

Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2026-2031. Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioriteteve bazuar në desk review, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë.

Konsultimet paraprake brenda bashkisë. Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratorët e NJA-ve. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundësuar njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët, por edhe për të diskutuar mbi detaje që lidhen me formatin dhe përmbajtjen në tërësi të PVVBGJ.

Konsultim me një grup të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh. Grupi i Punës mendoi që në takimin e tretë të tij (përkatësisht në datën xx xx 2026) të ftonte edhe një rreth të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh, për të diskutuar parimisht mbi përmbajtjen e PVVBGJ. Ky takim rezultoi shumë i suksesshëm, me pjesëmarrjen e 25 personave (15 gra dhe 10 burra).

Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2026 - 2031. Drafti i përgatitur për konsultim përmbante seksionet dhe të dhënat kryesore, vizionin, fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe masat e veprimet e parashikuara për arritjen e objektivave specifike, si dhe kostot e përlogaritura për zbatimin e tyre. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakortësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit. Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, OJF-të bashkëpunëtoresh, si dhe anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit Bashkiak. Në datën X qershor 2026 draft matrica e PVVBGJ u postua në faqen e internetit të bashkisë për konsultim publik, së bashku me njoftimin përkatës për datën e konsultimit. Në konsultimin kryesor të zhvilluara përkatësisht, në datën xx qershor 2026 u përfshinë rreth xx pjesëmarrëse e pjesëmarrës (xx gra dhe xx burra). Draft PVVBGJ 2026 – 2031 u qarkullua edhe nëpërmjet e-mailit në një numër të konsiderueshëm partnerësh e bashkëpunëtorësh (në xxx adresa e-maili), me qëllim dhënien e mundësisë për të pasur komentet e tyre dhe për ta zgjeruar maksimalisht procesin e konsultimit.

Kostimi i draft PVVBGJ 2026-2031. Pas finalizimit të matricës së aktiviteteve dhe qartësisht të tyre me çdo drejtori, paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakortësuara.

Miratimi i PVVBGJ 2026 – 2031 në Këshillin Bashkiak. Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ 2026 - 2031 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë, si dhe versionin anglisht i tij do të publikohet në faqen e Atlasit të Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE) Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes së PVVBGJve siç sugjerohet nga KBRE. Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PVVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar, përmes dy konsulentëve të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

Metodologjia e zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në Bashkinë Mallakastër bazohet në një qasje gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe të orientuar drejt rezultateve, e cila synon integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe shërbimeve publike.

Një element i rëndësishëm i kësaj metodologjie është përdorimi i instrumenteve të mbledhjes së të dhënave që mundësojnë vlerësimin real të situatës së barazisë gjinore në territorin e bashkisë. Në këtë kuadër, parashikohet hartimi dhe administrimi i një pyetësoni online dhe fizik për vlerësimin e situatës aktuale të përfshirjes së grave dhe respektimit të barazisë gjinore në komunitet.

Ky pyetësor do të përdoret si instrument bazë për:

identifikimin e perceptimeve të qytetarëve mbi barazinë gjinore dhe rolet gjinore në shoqëri;
vlerësimin e nivelit të përfshirjes së grave në jetën ekonomike, sociale dhe vendimmarrëse;
evidentimin e pengesave kryesore që kufizojnë pjesëmarrjen e grave dhe të rejave në komunitet;
mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës dhe karakteristikave të tjera sociale.

PYETËSORI

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Gjinia (Multiple choice)

Femër

Mashkull

Tjetër / preferoj të mos përgjigjem

2. Mosha (Multiple choice)

15–24

25–34

35–44

45–59

60+

3. Vendbanimi (Multiple choice)

Urban

Rural

4. Statusi (Multiple choice)

E punësuar

E papunë

Studente

Shtëpiake

Pensioniste

Tjetër

PUNËSIMI DHE EKONOMIA

5. A jeni e punësuar? (Po/Jo)

6. Nëse jo, arsyeja kryesore (Checkboxes)

Mungesë pune

Përgjegjësi familjare

Mungesë kualifikimi

Diskriminim gjinor

Tjetër

7. A kanë gratë të njëjtat mundësi pune si burrat?

Po

Jo

Pjesërisht

8. A keni marrë pjesë në trajnim profesional?

Po

Jo

SIPËRMARRJA

9. A do të hapnit një biznes?

Po

Jo

Ndoshta

10. Pengesat kryesore për gratë sipërmarrëse (Checkboxes)

Financimi

Informacioni

Familja

Diskriminimi

Stereotipet

Tjetër

VENDIMMARRJA

11. A jeni pjesë e ndonjë strukture komunitare?

Po

Jo

12. A janë gratë të përfaqësuara mjaftueshëm në vendimmarrje?

Po

Jo

Pjesërisht

13. Dëshironi të përfshiheni më shumë?

Po

Jo

STEREOTIPET

14. A ekzistojnë stereotipe gjinore në komunitet?

Po

Jo

Nuk e di

15. Ku hasen më shumë? (Multiple choice)

Familje

Shkollë

Punë

Media

Komunitet

DHUNA DHE SIGURIA

16. A ndiheni të sigurt?

Po

Jo

Pjesërisht

17. A dini ku të drejtoheni për dhunë në familje?

Po

Jo

18. A reagojnë institucionet në mënyrë efektive?

Po

Jo

Nuk e di

NEVOJAT

19. Shërbimet që duhen përmirësuar (Checkboxes)

Punësimi

Arsimi

Shërbime sociale

Kujdesi për fëmijët

Mbrojtja nga dhuna

20. Sugjerime (Paragraph)

tekst i hapur

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit do të shërbejnë si bazë për planifikimin e ndërhyrjeve të synuara, si dhe për monitorimin e progresit në zbatimin e PVVBGJ. Ato do të kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin e politikave vendore dhe në rritjen e efektivitetit të masave për barazinë gjinore.

Përveç pyetësorit, metodologjia përfshin gjithashtu trajnime, konsultime publike, takime me komunitetin, bashkëpunim ndërinstitucional dhe përdorimin e treguesve të ndjeshëm gjinorë për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm

Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit mbi barazinë gjinore në Bashkinë Mallakastër do të analizohen në mënyrë sistematike, me qëllim identifikimin e gjendjes aktuale të përfshirjes së grave dhe të rejave në jetën ekonomike, sociale dhe vendimmarrëse, si dhe evidentimin e sfidave kryesore që ndikojnë në barazinë gjinore në nivel vendor.

Analiza do të bazohet në metoda sasiore dhe cilësore, duke përfshirë përpunimin e të dhënave numerike (frekuenca dhe përqindje) dhe analizën e përgjigjeve të hapura për të kuptuar perceptimet, qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve.

Të dhënat do të ndahen sipas treguesve kryesorë si gjinia, mosha, vendbanimi (urban/rural) dhe statusi socio-ekonomik, me qëllim identifikimin e pabarazive dhe grupeve më të cënueshme në komunitet.

Rezultatet e analizës do të shërbejnë si bazë për:

përcaktimin e situatës fillestare (baseline) të barazisë gjinore në Bashkinë Mallakastër;

identifikimin e prioriteteve të ndërhyrjes në fushat e punësimit, arsimimit, vendimmarrjes dhe mbrojtjes sociale;

përcaktimin e treguesve të matshëm për monitorimin e zbatimit të PVVBGJ;

orientimin e politikave dhe masave konkrete të Bashkisë në fushën e barazisë gjinore.

Gjithashtu, rezultatet e analizës do të përdoren për hartimin e raporteve periodike të monitorimit dhe vlerësimit të progresit të planit, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie institucionale.

IV.VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni: "Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Mallakastres, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës".

Parimet që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, siç paraqiten në vijim:

Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.

Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe pengesave të shumëfishta.

Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, në vendimmarrje, është parakusht për një shoqëri demokratike.

Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.

Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.

Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes

VVBGJ 2026 - 2031 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021- 2031, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.

Kritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.

Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.

Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbrëthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Article I. V.REZULTATET E PRITSHME, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE TREGUESIT

Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë dhe fuqizimi ekonomik i grave dhe të rejave

Rezultatet e pritshme:

Veprimet e Bashkisë Mallakastër për nxitjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.

Masat për nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave të përshtatura me nevojat e tyre specifike dhe të zbatuara në mënyrë efektive.

Objektivi specifik I:

Rritja e aksesit të grave dhe të rejave ndaj shërbimeve, mundësive të punësimit, sipërmarrjes dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin e tyre ekonomik.

Treguesit:

- Numri i grave dhe të rejave përfituese nga programet e formimit profesional, i ndarë sipas moshës, vendbanimit, përkatësisë etnike/kulturore dhe aftësisë së kufizuar.
- Numri i ndërmarrjeve të reja të themeluara ose të drejtuara nga gra dhe të reja që kanë përfituar mbështetje financiare nga Bashkia Mallakastër gjatë periudhës së zbatimit të PVVBGJ, i ndarë sipas sektorëve ekonomikë.
- Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në vendimmarrjen publike dhe politike
- Aktivitetet për pjesëmarrjen në vendimmarrje adresojnë në mënyrë efektive stereotipet gjinore dhe nxisin përfshirje gjithëpërfshirëse.
- Veprimet e Bashkisë Mallakastër forcojnë zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe parimet e barazisë dhe përfaqësimit të drejtë.
-

Objektivi specifik II:

Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe të rejave në vendimmarrjen politike dhe publike në nivel vendor.

- Numri i grave dhe të rejave të trajnuara për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe integrimin gjinor në vendimmarrje.
- Përqindja e grave dhe të rejave në pozicione drejtuese në strukturat e Bashkisë Mallakastër, Këshillin Bashkiak, njësitë administrative dhe këshillat lokalë.

Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore i fuqizuar dhe më efikas.
- Një brez i ri i ndërgjegjshëm ndaj barazisë gjinore, i angazhuar në luftën kundër stereotipeve dhe diskriminimit.
- Komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të mbrojtura nga dhuna.
-

Objektivat specifike III:

Fuqizimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.

Reduktimi i stereotipeve gjinore dhe praktikave të dëmshme përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit.

Fuqizimi i grave dhe të rinjve për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, në përputhje me agjendat “Gruaja, Paqja dhe Siguria” dhe “Rinia, Paqja dhe Siguria”.

Treguesit:

- Numri i rasteve të dhunës në familje të referuara dhe të trajtuara nga MKR në raport me rastet e regjistruara.
- Përqindja e buxhetit të Bashkisë Mallakastër të dedikuar për shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës.
- Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.
- Përqindja e grave, të rejave dhe të rinjve të përfshirë në aktivitete për paqe, siguri dhe komunitete gjithëpërfshirëse.
- Integrimi gjinor në politikat vendore
- Rritje e ndjeshme e transparencës dhe përgjegjshmërisë së Bashkisë Mallakastër në zbatimin e angazhimeve për barazinë gjinore.
- Zbatim i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe integrim i perspektivës gjinore në politikat dhe programet vendore.

Objektivat specifike IV:

Rritja e transparencës dhe monitorimit të politikave të barazisë gjinore.

Zbatimi i integritimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.

Treguesit:

- Numri i raporteve të monitorimit të PVVBGJ të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe të publikuara zyrtarisht.
- Numri i programeve buxhetore të analizuara me perspektivë gjinore.
- Përqindja e buxhetit vjetor të Bashkisë Mallakastër e dedikuar për zbatimin e PVVBGJ dhe trendi i saj në rritje.

VI.KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2026 – 2031

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PVVBGJ 2026 – 2031 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeuku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj. - pra që nuk ka nevojë për kosto shtesë pasi këto kosto parashikohen në mënyrë të përvitshme, - në këtë Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2026 - 2031 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Në seksionin VII "Matrica e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2031", për çdo masë/aktivitet të parashikuar, në kolonën e kostos do të jepet informacion për:

Vlerën totale të kostos të zhvillimit të masës/aktivitetit. Kjo kosto është përllogaritur si kosto bazë (pra me zërat që përmban zbatimi i aktivitetit), e shumëzuar me numrin e aktiviteteve të parashikuara për zbatim për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të PVVBGJ.

Vlerën e kostos që mbulohet nga Bashkia. Këtu duhet pasur parasysh se kjo vlerë jo domosdoshmërisht është shtesë në buxhetin e bashkisë, ajo mund të jetë edhe në formën e angazhimit të pjesshëm të specialisteve/specialistëve të drejtorive përkatëse (pra disa ditë pune ia kushtojnë zbatimit të masës/aktivitetit, brenda pagës mujore që kanë), ose në formën e kontributit "në natyrë (in kind)" përmes vënies në dispozicion të sallave e ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përllogaritjet financiare.

Vlerën e kostos që mbulohet nga donatorët. Kjo nënkupton që për zhvillimin e masës/aktivitetit ka një dakortësi paraprake me donatorët mbi kontributin e tyre. Në këtë rast, janë përllogaritur si të mbuluara, vetëm kostot për ato aktivitete që ka pasur një dakortësi / marrëveshje mes bashkisë dhe donatorit, në momentin e përgatitjes së këtij PVVBGJ. Paralelisht, bashkia do vijojë punën për identifikimin e donatorëve të ndryshëm dhe shtimin e mbështetjes nga ana e tyre, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij PVVBGJ.

Hendeuku financiar. Ky ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negocimit me donatorët, bizneset, OJF të specializuara, etj., ose mund edhe parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2026-2029.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2031, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë,

Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve / masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përlllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2026 - 2031 janë në vlerën xxxxx lekë. Nga këto: xxxx lekë janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I "Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre". xxxxxxxx lekë janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II "Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor". xxxxxxxx lekë janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes III "Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje". xxxxxxxx lekë janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV "Integrimi gjinor në politikat vendore". Në totalin e kostos xxxxxx lekë të nevojshme për zbatimin në tërësi të PVVBGJ 2026- 2031 për të gjithë kohëzgjatjen e tij: xxxxx lekë janë kosto që do të mbulohen nga Bashkia (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë - salla, mjete, etj.), pra të cilat nuk kanë nevojë të përlllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukturore ekzistojnë. xxxxxx lekë janë kosto që mbulohen nga donatorë të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PVVBGJ-së). xxxxx lekë janë hendek financiar, për të cilat bashkia do të llojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në PBA-të e ardhshme, duke filluar nags PBA 2026-2029.

(Pasi të përfundojë kostimi, do të jepet një informacion më i zgjeruar këtu mbi kostot në total dhe për çdo objektiv specific, si dhe mbi boshllëkun financiar)

VII. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria ose Sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek Komisioni për Barazinë Gjinore / Grupi Monitorimit për zbatimin e PVVBGJ, që do të ngrihet menjëherë pas miratimit të këtij PVVBGJ në nivel të Bashkisë, me përfaqësuese dhe përfaqësues nga secila Drejtori në Bashki.

Menjëherë pas miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2031, si hap i parë i zbatimit të tij, do të hartohen gjithashtu edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike.

Raportimet mbi aktivitetet do të jenë periodike (çdo 3 muaj) ose në bazë të kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore / Grupit të Monitorimit në nivel bashkie, apo Kabinetit të Kryetares/Kryetarit.

Raportimet në bazë të objektivave specifike do të përgatiten dy herë në vit (çdo 6 muaj). Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit në nivel të objektivave do të kryhet nga Komisioni i Barazisë Gjinore si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak.

Bashkia ka përgjegjësinë të përgatisë dhe paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak një raport monitorimi çdo vit. Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Aleanca e Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor apo edhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

Bazuar në monitorimin e kryer, PVVBGJ duhet të rishikohet dhe përmirësohet në mënyrë periodike, sipas nevojës, qoftë edhe çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VIII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
2026-2031

Fusha e ndërhyrjes:	I Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore		
Rezultatet e pritshme:	<p>I.a. Përgjegjshmëria dhe transparencja e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm</p> <p>I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë.</p>		
Dokumentet kryesore që u referohemi:	<ul style="list-style-type: none"> - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality) - nenet 4, 5, 7, 8, 9 - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) - neni 3 - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) - fusha kritike 8 - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 6, 8 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtyllat 1, 5 - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2031 – objektivi specifik IV.3 		
Objektivi specifik:	I.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore		

Treguesi:	I.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë dhe KBRE-së		Baseline: 0 (2025)	KOSTO TOTALE	Target: 6 (2026)	
MASAT DHE AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	MONITORIMI	
		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË			
. Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026 – 2031 përmes një procesi konsultues e gjithëpërfshirës	Draft PVVBGJ i përgatitur		Të gjitha drejtoritë në bashki, NJA, qendrat sociale e komunitare, OJF, akademia, Aleanca e Grave Këshilltare, Këshilli Rinor, Këshilli Bashkiak, organizatat ndërkombëtare	3 Mujori i II 2026		Grupi i Punës përgjegjës për hartimin e PVVBGJ Bashkiak.
Miratimi i PVVBGJ (të kostuar) nga Këshilli Bashkiak	VKB për miratimin e PVVBGJ	Këshilli Bashkiak	Kabineti i Kryetarit, DMPS	3 Mujori i III 2026		KBGJ në nivel KB
Publikimi Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) të miratuar në faqen e internetit të Bashkisë dhe Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës, si dhe në Open Data	Linku i publikimit të PVVBGJ			3 Mujori i III 2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Ngrjtja me urdhër të Kryetarit i Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie me përfaqësuese dhe përfaqësues nga	Urdhri i Kryetarit	Kabineti i Kryetarit	DPSHS, DJ, DPBNJ	3M-III-2026 – 3M-III-2026		KBGJ në nivel KB

Drejtoria kryesore përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ						
Miratimi i rregullores së funksionimit të Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie (ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë), përgjatë gjithë zbatimit të PVVBGJ	Rregullorja e miratuar	Kabineti i Kryetarit		3M-III-2026 – 3M-III-2026		KBGJ në nivel KB
Përgatitja e mjeteve/formateve të unifikuara për mbledhjen e të dhënave për aktivitetet e zhvilluara për t'u përdorur nga secila drejtori në bashki	Formatet e përgatitura			3M-III-2026 – 3M-III-2026		KBGJ në nivel KB
Organizimi i takimeve të brendshme koordinuese me çdo drejtori përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ për të dakordësuar mbi fillimin e zbatimit të aktiiteteve	-Nr i takimeve të zhvilluara -Planifikimet e bëra		Secila drejtori përgjegjëse apo partnere për zbatimin e PVVBGJ	3M-III-2026 – 3M-III-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Fuqizimi i kapaciteteve të strukturës vendore për barazinë gjinore, si dhe të punonjëseve/punonjësve në nivel të NJA dhe lagjeve.	- Numri i trajnimeve të realizuara		Drejtorja e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPBNJ)	3M-III-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel KB
Shtimi i punonjëseve/punonjësve të	- Numri i punonjëseve		Drejtorja e Përgjithshme e	6M-I-2027 –		KBGJ në nivel KB

dedikuar për çështjet gjinore në nivel të NJA-ve dhe lagjeve	/punonjësve të shtuar në NJA dhe lagje		Burimeve Njerëzore (DPBNJ)	6M-II-2028		
Organizimi i takimeve periodike me partnerët dhe grupet e interesit mbi zbatimin e PVVBGJ dhe nevojën për përditësim të objektivave të tij.	3 takime të organizuara		Të gjitha drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ, OJF, media, akademia, bizneset, org	6M-II-2028 – 6M-II-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Ngritja e kapaciteteve të stafit të Bashkisë për monitorimin e zbatimit të PVVBGJ në përputhje me kërkesat e KBRE	Nr. trajnimeve të realizuara Nr. i mjeteve monitoruese të përgatitura	Drejtoria e të Dhënave (DDH)	DTZH, DMPS, DVPMAMS, DIEPH, OJF, org. ndërkombëtare	6M-II-2026 – 6M-I-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Përgatitja e raportit vjetor të monitorimit të zbatimit të PVVBGJ-së	3 raportë të përgatitura (1 në vit)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)	Të gjitha drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ, OJF, media, akademia, bizneset, org. ndërkombëtare	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Publikimi periodik i të dhënave për zbatimin e PVVBGJ në faqen e bashkisë dhe KBRE	Të dhënat e publikuara	Drejtoria e Medias dhe Publikimit (DMP)	DMPS, DTIK	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB

Objektivi specifik:	Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor						
Treguesit:	Numri i raporteve të monitorimit të buxhetit vjetor të shpenzuar, nga këndvështrimi gjinor, publikuar në faqen e internetit të bashkisë. Numri i dokumentave të rëndësishëm vendorë të monitoruar nga këndvështrimi gjinor			Baseline: 0 (2026) 1 (2026)		Target: 3 (2029) 4 (2029)	
MASAT DHE AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO TOTALE	MONITORIMI	
		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË				
Trajnimi i Komisionit për Barazi Gjinore (KBGJ) në nivel bashkie si dhe i drejtorisë përgjegjëse për organizimin e dëgjësive publike mbi rëndësinë e zbatimit të BPGJ, analizën gjinore dhe vlerësimin e ndikimit gjinor në zbatimin e veprimeve të ndërmarra nga bashkia.	Numri i trajnimeve të realizuara dhe personave të përfshirë ²	Drejtoria e Trajnimeve dhe Zhvillimit (DTZH)	DMPS, drejtoritë përkatëse që zbatojnë programet buxhetore që analizohen, KBGJ në nivel bashkie, akademia, OJF e specializuara, org. ndërkombëtare	6M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB	
Trajnimi dhe mentorimi i stafit të bashkisë për plotësimin e fishave të dërguara nga Ministria e Financave në kuadër të përgatitjes së buxheteve, si dhe për zbatimin e legjislacionit mbi BPGJ në nivel vendor.	Numri i trajnimeve dhe mentorimeve të kryera		DB, DF, KBGJ në nivel bashkie, akademia, OJF e specializuara, org. ndërkombëtare	3M-III-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB	
Analiza dhe vlerësimi i impaktit gjinor të shpenzimeve vjetore apo afatmesme të programeve buxhetore të bashkisë .	6 programe buxhetore të analizuar (2 çdo vit)		DF, DAB, DMPS, drejtoritë përkatëse që zbatojnë programet buxhetore që analizohen, KBGJ në nivel bashkie, akademia, OJF e specializuara, org.ndërkombëtare	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB	
Përfshirja e Nëpunësës së Barazisë Gjinore dhe personave të trajnuar për BGJ në nivel NJA dhe lagjeje, në të gjitha takimet/konsultimet publike që organizohen në kuadër të përgatitjes së	Numri i takimeve/ konsultimeve ku ka marrë pjesë NBJG		DB, DMPS, drejtoritë përkatëse që do kryejnë ndërhyrjet për të cilat aplikohen konsultimet publike	3M-II-2026 – 6M-II-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB	

buxhetit, apo ndërhyrjeve të ndryshme për zhvillim në komunitet.						
Përgatitja e një listë kontrolli me çështjet që duhet të mbahen në konsideratë gjatë ndërhyrjeve që bën bashkia në funksion të zhvillimit të komunitetit (infrastrukturë, mjedis, etj) – analizë e ndjeshme gjinore (ANGJ).	Listë kontrolli mbi ANGJ e përgatitur sipas fushave ku janë planikuar ndërhyrjet deri në 2024		Të gjitha drejtoritë që kanë planifikuar ndërhyrje në zhvillimin urban deri në 2024	3M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Vlerësimi i ndikimit gjinor mbi ndërhyrjet e realizuara në rehabilitimin e rrugëve dhe hapësirave publike, ndërtimin e këndeve të lojërave dhe ambjenteteve sportive, rikonstruksionin e godinave arsimore, shëndetësore, të kujdesit shoqëror, etj.	Raportet mbi VNGJ të përgatitura sipas ndërhyrjeve të realizuara		Të gjitha drejtoritë që kanë realizuar ndërhyrje në zhvillimin urban deri në 2024	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Monitorimi i zbatimit të të gjithë planeve apo strategjive vendore, nga këndvështrimi gjinor (plani i integritetit të pakicave kombëtare, plani i rinisë, etj)	Raportet e monitorimeve të realizuara		Të gjitha drejtoritë që përgjegjëse për realizimin e këtyre planeve	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore dhe rishikimi nga këndvështrimi gjinor i strategjive dhe planeve që do hartojë dhe miratojë bashkia në vazhdimësi (plani social, plani i strehimit social, etj.)	Nr. i dokumentave me perspektivën gjinore të integruar		Drejtoritë përgjegjëse për planet që hartohen, akademia, OJF e specializuara, org.ndërkombëtare	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Hartimi i një politike kundër ngacmimit seksual për punonjëset/punonjësit dhe qytetarët/qyetarët përfitues të shërbimeve të Bashkisë.	Politika e hartuar dhe publikuar		DPBNJ, akademia, OJF të specializuara, org. ndërkombëtare	6M-I-2027 – 6M-II-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB

Në matjen e treguesve të rezultateve, kur flitet për të evidentuar numrin e personave të përfshirë, të dhënat do të jenë gjithmonë të ndara sipas seksit, profesionit, sektorit që i perket, etj. Ngjashmërisht, edhe kur flitet për takime/trajnime dhe aktivitete në komunitet apo me të tretë, të dhënat do të jenë gjithmonë të ndara sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive të kufizuara, si dhe shumë karakteristikave të tjera personale të individëve.

Fusha e ndërhyrjes:	Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë					
Rezultatet e pritshme:	Një brez i ri i barazisë i krijuar, që lufton steriotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë. Informimi mbi përgjegjësitë prindërore dhe rolin e të dy prindërve në rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre duke luftuar steriotipet gjinore dhe praktikat e dëmshme, i rritur ndjeshëm					
Dokumentet kryesore që u referohemi:	<ul style="list-style-type: none"> - Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality) – nenet 6, 10, 13, 16, 20 - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) – nenet 2, 5, 10, 16 - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 2, 9 - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 1/b, 4/2, 4/3, 12/1, 12/6, 13, 14, 17 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – objektivi specifik tematik 2 - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2031 – objektivi specifik III.4 					
Objektivi specifik:	II.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore					
Treguesi	II.1.a. Numri i personave të përfshirë në aktivitetet edukuese për të luftuar steriotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë.			Baseline: Do përcaktohet gjatë 202263	Target: Do rritet me 31%	
MASAT DHE AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO TOTALE	MONITORIMI
		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË			
Publikimi i një botimi me modele të grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjitha fushat, të cilat kanë bërë histori ndër vite, duke evidentuar ndryshimet pozitive të sjella prej tyre.	1 botim i publikuar	Drejtorja e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore (DKTK)	Drejtorja e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore (DKTK) OJF	6M-I-2027 – 6M-II-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Takime informuese me nxënëset dhe nxënësit, si dhe studentet e studentët, me pjesëmarrjen edhe të vetë grave të evidentuara si modele pozitive.	40 takime të zhvilluara për vitin 2026-2027 në shkolla	Drejtorja e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore (DKTK)	Drejtorja e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore (DKTK) OJF	6M-II-2027 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB

³ Ky përcaktim mund të bëhet duke u bazuar edhe në aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2025 për këtë qëllim

Emisione në media ko (TV dhe radio)Lokale mbi modelet e grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha fushat, të cilat kanë bërë histori ndër vite.	1 cikël emisionesh me 10 biseda të zhvilluara	Drejtoria e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore (DKTK)	Drejtoria e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore (DKTK)OJF	6M-II-2027 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Evidentimi dhe mbështetja e vajzave dhe të rejave që përfshihen në sporte “jo tradicionale për to” (promovimi i skuadrës së futbollit për vajzat, etj), në nivel të NJA-ve dhe lagjeve.	Numri i vajzave të mbështetura në secilën NJA dhe lagje	Drejtoria e Sporteve (DS)	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbështetja e aktiviteteve kulturore dhe artistike që promovojnë fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave dhe sfidojnë stereotipet gjinore	Numri i aktiviteteve të mbështetura (3 aktivitete AFS)	Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit (DPPQ)	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Trajnime me gazetarët e gazetarët në lidhje me mënyrën e paraqitjes së modeleve pozitive të grave, të rejave e vajzave në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	15 trajnime të realizuara (5 trajnime çdo vit)	Drejtoria e e Medias dhe Komunikimit (DPMK)	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Fuqizimi i kapaciteteve të Këshillit Rinor për t’u përfshirë më aktivisht në proceset vendimmarrëse	Numri i trajnimeve të organizuara me Këshillin Rinor	Drejtoria e Përfshirjes Sociale	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Fuqizimi i kapaciteteve të Aleancës së Grave Këshilltare dhe Komisionit të Barazisë Gjinore për të zbatuar iniciativa që zvogëlojnë stereotipet gjinore, seksizmin dhe dhunën ndaj grave, të rejave e vajzave në vendimmarrjen politike e publike.	9 trajnime të zhvilluara (3 trajnime çdo vit)	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Informimi nëpërmjet mediave sociale mbi fuqizimin e grave dhe reduktimin e stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore, etj., çdo datë 25, si dhe në data të	45 mesazhe të dedikuara (15 çdo vit – 3 nga AFS), të	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB

shënuara ndërkombëtare (dita ndërkombëtare e grave, dita ndërkombëtare e fëmijës vajzë, etj).		përgatitura edhe në romisht dhe me gjuhën e shenjave					
Organizimi i përvitshëm i Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje (25 nëntor – 10 dhjetor).		3 fushata të realizuara, me materiale të përgatitura edhe në romisht dhe me gjuhën e shenjave	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kulturës	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Përfshirja në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe fakultete të tjera, i moduleve për të punuar me djemtë dhe burrat si aleatë të grave dhe vajzave për barazinë gjinore dhe për të luftuar dhunën me bazë gjinore		Modulet e shtuara	Drejtoria e Shërbimeve Sociale (DPSHS)	OJF	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Objektivi specifik:	Investimi në prindërimin pozitiv						
Treguesi	Numri i prindërve që vlerësojnë dhe marrin pjesë në iniciativat e bashkisë mbi prindërimin pozitiv			Baseline: Do përcaktohet në 2027		Target: 31% më shumë në (2028)	
MASAT DHE AKTIVITETET		TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO TOTALE	MONITORIMI
			DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË			
Trajnimi i stafit të qendrave komunitare/sociale të bashkisë mbi krijimin e kurseve për prindërimin pozitiv.		Nr i trajnimeve të realizuara (20 AFS)	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	OJF	3M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB

Aplikimi i kurseve të prindërimit pozitiv si pjesë e aktiviteteve në qendrat komunitare/sociale të Bashkisë.	Nr i kurse të aplikuara	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	OJF	6M-I-2027 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Trajnimi i administratoreve / administratorëve antarë të Bordeve të shkollave, mbi komunikimin dhe rëndësinë e prindërimit pozitiv	Nr i trajnimeve të realizuara 10 trajnime në 3 shkolla)	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	OJF	6M-I-2027 – 6M-I-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Ngritja e "Klubeve të prindërimit pozitiv" në kuadër të funksionimit të "shkollave si qendër komunitare"	Numri i klubeve të ngritura	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	OJF	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Përgatitja e një materiali informues mbi legjislacionin, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me martesën dhe familjen, për t'u përdorur për këshillimin e çifteve përpara celebrimit (duke evidentuar edhe pasojat e martesave të djemve të rinj me gra më në moshë, për shkak të marrjes së mbiemrit)	Materiali i përgatitur	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	OJF	6M-I-2027 – 6M-I-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Trajnimi i punonjëseve dhe punonjësve të gjendjes civile, zyrës së shërbimeve me një ndalesë, qendrave komunitare, si dhe NJA për të shpërndarë informacionin për këshillimin e çifteve përpara celebrimit.	Nr i trajnimeve të realizuara	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	OJF	6M-II-2027 – 6M-II-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Pilotimi i iniciatës për këshillim paramartesor pranë zyrës së gjendjes civile.	Nr i çifteve të këshilluara	Drejtoria e Licencimit dhe Gjendjes Civile (DLGJC)	OJF	6M-I-2028 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Fusha e ndërhyrjes:	III. Avancimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.					
Rezultatet e pritshme:	III.a. Veprimet e bashkisë për të krijuar një mjedis punësimi ku harmonizohet jeta personale me atë profesionale, të rritura ndjeshëm.					

	III.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejavve, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.					
Dokumentet kryesorë që u referohemi:	<ul style="list-style-type: none"> - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 11, 17, 27 - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) – nenet 11, 12, 13 - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 6 - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – neni 12/6 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla III, fushat kryesore tematike 3.3, 3.6 - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2031 – objektivet specifike I.1, I.2, I.3 					
Objektivi specifik:	Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi.					
Treguesi	Numri i personave të pajisur me informacion për luftimin e stereotipeve gjinore në punësim dhe balancimin e jetës profesionale dhe personale.	Baseline: Do përcaktohet gjatë 2026	Target: 31% më shumë (2028)			
MASAT DHE AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO TOTALE	MONITORIMI
		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË			
Mbledhja e informacionit periodik mbi vajzat dhe të rejtat që studiojnë në shkencë, teknologji, inxhinieri e matematikë, si dhe mbi të rejtat, gratë, të rinjtë e burrat e punësuar në profesione “jo tradicionale”, në cdo NJA dhe lagje	1 Databazë e përditësuar (në bazë tre-mujore)	Drejtorja e të Dhënave ?? (DDH)	ZVAP, ZVP, OJF të specializuara,	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Takime informuese me punëdhënësit dhe punëkërkeset/punëkërkesit e papunë mbi programet ekzistuese të nxitjes së punësimit dhe përfitimet grupe të ndryshme në nevojë, përfshirë të rejtat/rinjtë me ide inovative e që duan të integrohen në tregun e punës⁴	Numri i takimeve të realizuara ⁵	Drejtorja e Nxitjes së Punësimit (DNP)	ZVP, OJF	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Takime informuese me edukatorët, mësueset dhe mësuesit, si dhe me nxënëset dhe nxënësit e	Numri i takimeve të realizuara	Drejtorja e Politikave Lokale	DPS, OJF të specializuara,	3M-II-2026 –		KBGJ në nivel bashkie dhe

⁴ Takimet do të fokusohen në shpjegimin e zbatueshmërisë së VKM 17/2020; VKM 535/2020; VKM 348/2020 si dhe VKM 608/2020

⁵ Duhet të përcaktohen sa do zhvillohen në vit, me qëllim përlogaritjen e kostove. Kjo vlen për cdo tregues të tillë në plan

shkollave 9-vjeçare e të mesme mbi rëndësinë e zgjedhjes së profesioneve jo tradicionale, si dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së vajzave e të rejave në shkencë, teknologji, inxhinieri e matematikë.		Arsimore (DPLA)		6M-II-2028		KBGJ në nivel KB
Takime informuese në NJA dhe lagje mbi rëndësinë e ndarjes së barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.	Numri i takimeve të realizuara	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Takime informuese me punonjëset dhe punonjësit e institucioneve private / bizneseve për të nxitur kërkimin e të drejtës për marrjen e lejeve të paguara, sidomos nga baballarët.	Numri i takimeve të realizuara	Drejtoria e Nxitjes së Punësimit (DNP)	ZVP, OJF të specializuara,	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Emisione në media TV dhe radio mbi format e lejeve të paguara, të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar.	Numri i emisioneve të realizuara	Drejtoria e Nxitjes së Punësimit (DNP)	ZVP, OJF të specializuara,	3M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Publikimi i informacioneve të ndryshme në mediat sociale për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim, për balancimin e jetës personale me atë profesionale, si dhe ndarjen e punëve e kujdesit në familje.	Linqet ku publikohet informacioni	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DPS)	DNP, ZVP, OJF të specializuara,	6M-I-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Objektivi specifik:	Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive					
Treguesi:	Numri i grave dhe të rejave sipërmarrëse të mbështetura për avancimin drejt zhvillimit ekonomik të qendrueshëm të fokusuar në ekonominë e gjelbër			Baseline: 2026	Target: Rritur me 31% në 2028	
MASAT DHE AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO TOTALE	MONITORIMI
		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË			
Nxitja e bizneseve dhe bashkëpunimi për ofrimin e kujdesit për fëmijët në ambjentet e punës	Numri i bizneseve që e	Drejtoria e Përgjithshme e	bizneset, OJF të specializuara, org. ndërkombëtare	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe

	ofrojnë këtë shërbim	Shërbimeve Sociale				KBGJ në nivel KB
Mbështetja e grave nga grupe vulnerabël dhe të rejave që me sipërmarrjet e tyre përcjellin trashëgiminë kulturore të qytetit, me brandimin e produkteve dhe pjesëmarrjen e tyre në panairët dhe festat e organizuara nga bashkia.	Numri i grave dhe të rejave të mbështetura	Drejtoria e Promovimit dhe Zhvillimit të Industrisë së Turizmit (DPZHIT)	DTIK, DIEPH, ZVP, OJF të specializuara, akademia, org. ndërkombëtare	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbështetja e grave dhe të rejave nga grupet vulnerabël, që fillojnë një aktivitet ekonomik, apo aktiviteti i të cilave është dëmtuar në kushte të emergjencave civile e situatave të fatkeqësive natyrore, duke i lehtësuar me heqjen e tarifave vendore për një periudhë kohore dy vjeçare.	Numri i grave / të rejave të mbështetura	Drejtoria e Monitorimit të Taksës dhe Tarifave Vendore (DMTTV)	DB, DZHER, DZHEU, DMPS, ZVP, OJF të specializuara, org. ndërkombëtare	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja “të gjelbërta” të cilat bazohen në një model ekonomik, ose për biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta” duke futur elementë go-green në to.	- Numri i bizneseve të mbështetura - Numri i grave dhe të rejave të mbështetura nga numri i përgjithshëm i bizneseve të mbështetura	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Urban (DZHEU)	DPS	3M-II-2026 – 6M-II-2027	24,000,000 lekë (12,000,000 lekë në vit për secilin nga vitet 2022 dhe 2023)	KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Ndërhyrja për fuqizimin ekonomik të grave në zinxhirin e vlerës së artizanatit	- Numri i grave dhe të rejave të mbështetura	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural (DZHER)	OJF të specializuara,	3M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Krijimi i mundësisë dhe nxitja e bashkëpunimit (apo iniciativave binjakëzuese) ndërmjet komunitetit të grave, të rejave dhe vajzave	Numri i binjakëzimeve të kryera	Drejtoria e Zhvillimit	ZVP, OJF të specializuara,	6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe

sipërmarrëse në Mallakaster dhe grave, të rejave e vajzave sipërmarrëse të Qarkut Fier	- Numri i sipërmarrjeve të nxitura/krijuara	Ekonomik Urban (DZHEU)				KBGJ në nivel KB
Takime informuese me gratë dhe të rejtat në NJA dhe lagje mbi të drejtat pronësore të tyre, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore.	Numri i takimeve të zhvilluara	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Rural (DZHER)	DPS, DNP, ZVP, OJF të specializuara,	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Trajnime falas për gratë, të rejtat dhe vajzat me të ardhura të pamjaftueshme, mbi përdorimin e teknologjisë, dixhitalizimin, të punuarit online, etj.	Modulet e përgatitura Numri i trajnimeve të zhvilluara në qendrat komunitare cdo vit	Drejtoria e Kujdesit Social	DPS, DNP, ZVP, OJF të specializuara,	3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Fusha e ndërhyrjes:	IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat si dhe burrat të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private					
Rezultatet e pritshme:	IV.a. Informimi dhe elementët e sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike e private, të rritura ndjeshëm. IV.b. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe eficient					
Dokumentet kryesorë që u referohemi:	<ul style="list-style-type: none"> - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 21, 22, 23 - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) – nenet 2/6, 6 - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 9 - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 7, 8, 11, 13, 16, 19, 22, 23, 50, 51, 52, 53, etj. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla III, fusha kryesore tematike 3.1, 3.5 - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2031 – objektivet specifike II.1, III.2 					
Objektivi specifik:	IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, të cilat janë miqësore dhe të përshtatura për cdo grupmoshë e për të gjithë banoret e banorët e Tiranës					
Treguesi	IV.1.a. Përqindja e buxhetit dedikuar përmirësimit të hapësirave publike dhe kthimit të tyre në hapësira të sigurta për të gjithë			Baseline: Do përcaktohet për 2026		Target: Rritur me 31% (2028)

MASAT DHE AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO TOTALE	MONITORIMI
		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË			
Trajnimi i stafit të bashkisë dhe NJA-ve e lagjeve mbi elementët kryesorë të auditimit për sigurinë në hapësirat publike.	Numri i trajnimeve të zhvilluara	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DMPS)	OJF të specializuara,	6M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Takime në NJA dhe lagje me gra, të reja, vajza, burra të rinj dhe djem për të diskutuar mbi nivelin e sigurisë/pasigurisë që kanë në hapësirat publike.	27 takime të zhvilluara	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DMPS)	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	3M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Adresimi në KVSP i problematikave të evidentuara mbi sigurinë në hapësirat publike.	1 mbledhje e KVSP dedikuar mbi gjetjet nga takimet	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DMPS)	OJF të specializuara	6M-II-2026 – 6M-II-2026		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Marrja në konsideratë dhe përmirësimi i elementëve të mbrojtjes dhe sigurisë në hapësirat publike në çdo ndërhyrje infrastrukturore të realizuar nga bashkia.	Lista me elementët e sigurisë të përmbushur për çdo ndërhyrje	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPPZHT)		6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Takime informuese me vajza, të reja dhe gra për njohjen e Rezolutës 1325.	27 takime në NJA/Lagje	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DMPS)		6M-II-2026 – 6M-I-2027		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Takime informuese me nxënëset dhe nxënësit mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.	81 takime të realizuara (20 takime çdo vit)	Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore (DPLA)		6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB

Trajnime të përbashkëta të MKR, GTN dhe KVSP mbi trajtimin e rasteve të ndryshme të dhunës në hapësirat publike e private.	Numri i trajnimeve të realizuara	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DMPS)		6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Objektivi specifik:	Fuqizimi dhe rritja e eficensës së qasjeve shumësektoriale të koordinuara kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.					
Treguesi:	% e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore			Baseline: Do përcaktohet (2022)	Target: Ritur me 10% (2024)	
MASAT DHE AKTIVITETET	TREGUESIT E REZULTATEVE	ZBATIMI		AFATI KOHOR	KOSTO TOTALE	MONITORIMI
		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË			
Fuqizimi i Njësisë kundër Dhunës në Familje në bashki, duke parashikuar shtim të personelit (nr. Të koordinatorëve vendorë) në përputhje me VKM 327/2021.	Numri I punonjësve të shtuara në Bashki		DPSHS	6M-I-2027 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Shtimi I punonjësve/punonjësve përgjegjës në NJA për të mbuluar detyrimet lidhur me trajtimin e rasteve të DHBGJ	Numri i punonjësve / punonjësve të shtuar në NJA dhe lagje	Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore (DPBNJ)		6M-I-2027 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Fuqizimi i kapaciteteteve të punonjësve/punonjësve të shtuar në NJA dhe lagje, për të trajtuar sic duhet rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore	Numri i trajnimeve të realizuara	Drejtoria e Përfshirjes Sociale (DMPS)		M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Organizimi i mbledhjeve të rregullta mujore të ETN dhe diskutimi mbi menaxhimin e rasteve.	36 mbledhje të realizuara (12 çdo vit)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Komitetit Drejtues dhe marrja e vendimeve për kapërcimin e vështirësive të ndeshura.	6 mbledhje të organizuara (2 mbledhje çdo vit)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe

		Përfshirjes Sociale (DMPS)				KBGJ në nivel KB
Organizimi i mbledhjeve të rregullta të GTN për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar	36 mbledhje të realizuara (12 çdo vit)	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe koordinuese për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës ndaj fëmijëve dhe viktimave të mundshme apo viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.	Numri i rasteve të menxhuara nga bashkia çdo vit dhe sipas problematikës	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbledhja në mënyrë sistematike dhe rregjistrimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje në sistemin REVALB.	Sistemi REVALB i plotësuar dhe përditësuar	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Trajnimi i edukatoreve në çerdhe e kopshte për identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve që mund të jetojnë në familje ku ushtrohet dhunë.	Numri i trajnimeve të zhvilluara	Drejtoria e Politikave Lokale të Arsimit (DPLA)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbështetja e funksionimit të shërbimeve lokale për rastet e dhunës në familje (shërbime për gratë dhe burrat e dhunuar).	- Numri i shërbimeve të mbështetura - % e buxhetit të dhënë	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbështetja e funksionimit të shërbimeve lokale për rastet e fëmijëve të abuzuar.	- Numri i shërbimeve të mbështetura - % e buxhetit të dhënë	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB

Mbështetja e funksionimit të shërbimeve lokale për rastet e trafikimit të qenieve njerëzore	- Numri i shërbimeve të mbështetura - % e buxhetit të dhënë	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbështetja e shërbimit të riintegrit të viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore	- Shërbimi i mbështetur - % e buxhetit të dhënë	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		3M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Zhvillimi dhe zbatimi i planit socio-ekonomik të riintegrit, për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore	- Plani i zhvilluar dhe i mbështetur për zbatim	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
Mbështetja nëpërmjet programeve të banesave sociale me qera, banesave të specializuara dhe kredive të buta për strehimin afatgjatë të viktimave të dhunës me bazë gjinore.	Numri i viktimave që u sigurohet strehim afatgjatë çdo vit	Drejtoria e Strehimit Social		6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB
. Parashikimi I dhënies së mbështetjes financiare të rasteve të dhunës në familje me UM në përputhje me nenin 10/k të liggjit, kur ky detyrim vendoset nga Gjykata	- Numri i rasteve të mbuluara me shërbimin financiar	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale (DMPS)		6M-II-2026 – 6M-II-2028		KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJ në nivel KB